

KONTRATË

PËR THEMELIMIN E SHOQËRISË "FAVINA 1" SH.P.K.



E lidhur midis palëve:

- 1 - **Viktor Qylafi**, i biri i Fatmirit, i datëlindjes 1963, lindur dhe banues në Lumalas, Korce, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar me pasaporte Nr. Z. 0166919
- 2 - **Adnand Qylafi**, i biri i Fatmirit, i datëlindjes 19466, lindur dhe banues ne Lumalas, Korce, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me pasaporte Nr. Z 1060644.

Të gjitha palët e mësipërme, duke qënë të pranishëm, të deklaruar ortakë, ranë dakord që kontratën e themelimit të shoqërisë së përbashkët ta formulojnë sipas kërkesave të ligjit 7667, datë 28/01/1993, dhe ligjit 7638, datë 19/11/1992 "*Për shoqëritë tregtare*", dhe Ligjit Nr. 9072 date 22.05.2003 "Per Sektorin e Energjise Elektrike" vendosën sa më poshtë:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Themelohet ndërmjet tyre një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e quajtur "**FAVINA 1**" SH.P.K.

Neni 2

Shoqëria e sipërpërmendur ngrihet sipas ligjit shqiptar dhe e ka selinë e saj në Korce. Lagja 7, Rruga Misto Mame, Nr. 13, Rr. Riza Cerova .
Administrator i Shoqerise zgjidhet **Viktor Qylafi**

Neni 3

Sipas ligjit shqiptar Shoqëria është një person juridik privat dhe veprimtaria e saj do të ushtrohet në përputhje me aktet e krijimit të saj (akti themelues dhe statuti) si dhe të legjislacionit shqiptar, Rregulloren dhe Rregullat e ERE-se.

Neni 4

Shoqëria përgjigjet me pasurinë e saj.
Në asnjë rast shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e ortakëve.
Ortakët nuk përgjigjen personalisht për detyrimet e shoqërisë.
Shoqëria përgjigjet për detyrimet e saj ndaj shtetit ose ndaj të tretëve brenda kufirit të mjeteve të saj financiare.

Neni 5

Shoqëria mund të ndryshojë emrin, selinë dhe veprimtarinë e saj me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Për çdo ndryshim, Shoqëria është e detyruar brenda 10 diteve të njoftojë ERE-ne.

Neni 6

Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në HC Vithkuq, Korce.

II. OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Neni 7

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj ushtrimin e aktivitetit privat në fushën e:

1. Prodhimin i energji elektrike nga centralet elektrike ekzistues me kapacitet të përgjithshëm jo më të madh se 5 MW në përputhje me standartet e paraqitura në Rregulloret dhe Rregullat e miratuara nga ERE-ja.
2. Blerje dhe shitja me shumicë i energji elektrike nga njesitë e prodhimit të subjekteve të licensuar dhe shitja me pakicë tek konsumatorët.
3. Furnizimi me energji elektrike për konsumatorët brenda zonës të caktuar me tarifa të rregulluara nga ERE
4. Blerje trojesh, prona të tjera dhe të kryejë punë ndertuese përsa kohë këto veprime përputhen me Rregulloren dhe Rregullat e ERE-s.

III. KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Neni 8

Kohëzgjatja e shoqërisë është vendosur mbi 10 vjet.

Të paktën një vit para mbarimit të këtij afati, palët mund të vendosin zgjatjen e këtij afati dhe 10 vjet të tjera. Do të jetë detyrë e shoqërisë, që në përputhje me ligjet në fuqi, të paraqesë kërkesën si dhe dokumentacionin e nevojshëm në autoritetet kompetente shqiptare.

IV. KAPITALI

Neni 9

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga kapitali themeltar prej 100000 (njëqindmijë) lekë, i vendosur në shoqëri sipas ortakëve si më poshtë:

- Viktor Qylafi 50.000 lekë = 50 % të kapitalit
- Adnand Qylafi 50.000 lekë = 50 % të kapitalit

Neni 10

Dorëzimet e ortakëve do të jenë të pasqyruara në kontabilitetin e shoqërisë dhe në librin e ortakëve.

V. ORGANET E SHOQËRISË

Neni 11

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- *Asamblea e Ortakëve,*
- *Administratori.*

Neni 12

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj sipas kushteve të përcaktuara në Licensën Nr. 23 miratuar me Vendimin Nr. 26 dt. 27.05.2005 të ERE- se.

VI. VEPRIMTARIA DHE FITIMI I SHOQËRISË

Neni 13

Shoqëria realizon fitimin me ushtrimin e veprimtarisë së saj të përcaktuar në aktin themelues dhe në statut.

Neni 14

Ortakët kanë të drejta mbi fitimin që shoqëria realizon. Fitimi neto rezulton nga bilanci vjetor i shoqërisë, i përpiluar në përputhje me statutin a saj dhe legjislacionin shqiptar, mbas pagimit të taksave, tatimeve dhe pagave.

Neni 15

Ortakët marrin pjesë në shpërndarjen e fitimit sipas kuotave të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 16

Ndarja e fitimit do të përcaktohet nga Asambleja e Ortakëve me miratimin e bilancit vjetor.

VII. MARRDHËNIET E PUNËS

Neni 17

Marrdhëniet e punës të shoqërisë me punonjësit rregullohen me kontratën individuale të punës, në mbështetje me kontratën kolektive.
Mosmarrëveshjet e punonjësit me shoqërinë zgjidhen në gjykatën shqiptare.

VIII. MOSMARRËVESHJET

Neni 18

Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin lidhur me objektin e veprimtarisë së shoqërisë dhe që nuk zgjidhen me mirëkuptim, organi kompetent për zgjidhjen e tyre është ERE-ja. Apeli kundër Vendimeve të ERE-se është *Gjykata e Shkalles së Parë të Rrethit, Tiranë*.

Mosmarrëveshjet e mundshme që mund të kenë ortakët, nëse nuk do të rezultojnë të zgjidhura miqësisht, do të shqyrtohen nga *Gjykata e Rrethit, Tiranë*.

IX. DISPOZITA KALIMTARE TË FUNDIT

Neni 19

Shoqëria shpërndahet:

- Në rastet e parashikuara nga legjislacioni shqiptar,
- Me mbarimin e afatit të përcaktuar,
- Kur ortakët vendosin të tërheqin fondet e investuara, dhe
- Kur shpallet procedura e falimentimit.

Neni 20

Shoqëria fiton personalitetin juridik me vendimin e regjistrimit në *Gjykatën e Rrethit, Tiranë*.

Neni 21

Ky akt themelues hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij nga palët.

Neni 22

Kjo kontratë është e përpiluar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe.



ORTAKËT

Adnand Qylafi

Viktor Qylafi

57A7U77

I SHOQËRISË “ FAVINA 1” SH.P.K.



**I. KRIJIMI, FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI,
SELIA DHE KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Neni 1

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “FAVINA 1”, SH.P.K., me qendër në Korce, Lagja 7, Rruga Misto Mame, Nr. 13, është krijuar në bazë të kontratës që i bashkangjitet ky statut, të përpiluar dhe të nënshkruar nga:

- 1 - **Viktor Qylafi**, i biri i Fatmirit, i datëlindjes 1963, lindur dhe banues në Lumalas, Korce,
- 2 - **Adnand Qylafi**, i biri i Fatmirit, i datëlindjes 1966, lindur dhe banues në Lumalas, Korce.

Neni 2

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë tregtare në Shqipëri, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe në përputhje me dispozitat e këtij statuti.

Shoqëria e fiton personalitetin juridik nga dita e regjistrimit të saj.

Neni 3

Emërtimi i shoqërisë është “FAVINA 1” SH.P.K.

Neni 4

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj ushtrimin e aktivitetit privat në HC Vithkuq Korce, për:

1. Prodhimin i energjië elektrike nga centralet elektrike ekzistues me kapacitet të pergjithshem jo me te madh se 5 MW ne perputhje me standartet e paraqitura ne Rregulloret dhe Rregullat e miratuara nga ERE-ja.
2. Blerje dhe shitja me shumice i energjië elektrike nga njesite e prodhimit te subjekteve te licensuar dhe shitja me pakice tek konsumatorët.
3. Furnizimi me energji elektrike per konsumatorët brenda zones te caktuar me tarifa te rregulluara nga ERE
4. Blerje trojesh, prona te tjera dhe te kryeje pune ndertuese persa kohe keto veprime perputhen me Rregulloren dhe Rregullat e ERE-s.

Neni 5

Selia e shoqërisë është në Korce, Lagja 7, rruga Misto Mame Nr. 13. Selia e Shoqërisë mund të ndryshojë në përputhje me Rregulloren dhe Rregullat e ERE-se dhe Legjislacioni në fuqi.

Shoqëria ka vulën me emrin e saj.

Neni 6

Kohëzgjatja e shoqërisë është përcaktuar për një periudhë mbi 10 vjet, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj. Kjo periudhë mund të shkurtohet në rast se shoqëria priset para kohe.

II. KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTI, PJESET E KAPITALIT THEMELTAR.

Neni 7

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100000 (njëqindmijë) lekë.

Neni 8

Kapitali themeltar përbëhet nga kontributi i ortakëve i ndarë si më poshtë:

- Viktor Qylafi 50.000 lekë = 50 % të kapitalit
- Adnand Qylafi 50.000 lekë = 50 % të kapitalit

Neni 9

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie, në rast ndarje pasurore ndërmjet bashkëshortëve dhe nëpërmjet paraardhësve e pasardhësve.

Neni 10

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë më miratimin e tërë ortakëve

Në rast se pjesa e kapitalit që transferohet është mbi 30% të aseteve të Shoqërisë atëherë brenda 10 ditëve duhet të njoftohet ERE-ja nga Shoqëria e Licensuar.

Neni 11

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar gjithmonë duhet të vërtetohet me *Akt - Noterial*.

III. MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI KOMPETENCA DHE KONTROLLI I SHOQËRISË

Neni 12

Organi më i lartë vendimor i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.

Në Asamble marrin pjesë Ortakët me të drejtë vote në përpjestim me kuotën respektive të kapitalit të shoqërise.

Asambleja e Ortakëve vendos për bilancin vjetor, për ndryshimet në statut, për rritjen ose paksimin e kapitalit themeltar, për mbylljen e Shoqërisë. Cdo ortak mund të përfaqsohet nga një person tjetër. Unanimiteti në vendimet është i domosdoshëm për:

- Ndryshimet në statut,
- Zgjatjen e veprimtarisë së Shoqërisë,
- Mbylljen e aktivitetit të Shoqërisë.

Për të gjitha problemet e tjera Asambleja e Ortakëve vendos me shumicë votash. Në Asamble çdo kuotë e kapitalit themeltar përfaqësohet nga një votë.

Asambleja e Ortakëve mbledhet të paktën një herë në vit, sipas parashikimit të shkruar të paktën 30 ditë përpara.

Neni 13

Objekti i veprimtarisë të Shoqërisë "FAVINA 1" shpk mbështetet dhe rregullohet në përputhje të plote me Ligjin Nr.9072 dt. 22.05.2003 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" dhe brenda kushteve të licensimit të saj me Licensën Nr. 23 . të miratuar me Vendimin Nr. 26 dt. 27.05.2005 të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE).

Neni 14

Administrator i Shoqërisë është **Viktor Qylafi**

Administratori ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë dhe në emër të saj, nëpërmjet kompetencave që i janë përcaktuar në këtë statut. Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendimin e ortakëve që përfaqësojnë me teper se gjysmen e pjesës të kapitalit themeltar. Emërimi i tij bëhet për 5 (pese) vjet financiarë.

Neni 15

Administratori është përgjegjës individualisht ose solidarisht sipas rastit, ndaj shoqërisë apo të tretëve, për shkelje të ligjeve, të dispozitave të këtij statuti apo për faje gjatë administrimit të shoqërisë.

Neni 16

Disa nga kompetencat që i jepen administratorit janë:

- Të sigurojë drejtimin e mirë të shoqërisë,
- Të administrojë pasurinë e shoqërisë,
- Të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët,
- Të përfaqësojë shoqërinë para organeve gjyqësore ose të autorizojë persona të tjerë kompetentë.
- Të kryejë veprime juridike me të tretët, në emër dhe për llogari të shoqërisë, të tilla si: lidhje kontratash, çelje kredish, kryerje veprimesh bankare etj brenda limitit që i lejojnë ortakët.

Neni 17

Kontrolli i shoqërisë kryhet nga një ekspert kontabël i cili emërohet dhe shkarkohet nga tërë ortakët.

IV. VITI FINANCIAR DHE LLOGARITË VJETORE

Neni 18

Cdo vit financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përgjatë vitit i parë financiar fillon ditën e regjistrimit si person juridik.

Neni 19

Llogaritë vjetore, inventari, raporti mbi veprimtarinë e vitit financiar të hartuara nga administratori, nga eksperti kontabël i autorizuar, miratohen nga tërë ortakët.

Neni 20

Bilanci vjetor i veprimtarisë së shoqërisë nxirret brenda 31 Marsit të vitit pasardhës.

Neni 21

Tërë ortakët vendosin për qëllimin e përdorimit të fitimeve neto të realizuara nga veprimtaria e shoqërisë, mbasi zbriten të gjitha shpenzimet e kryera; ato mund të përdoren për: investime, nxitje ekonomike, reklama tregtare etj.

Neni 22

Shoqëria ka të drejtën e përdorimit lirisht të fitimeve dhe të disponimit lirisht të pasurisë së saj në përputhje me qëllimin e objektit të veprimtarisë që kryen.

Neni 23

Detyrimet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë ajo i mbulon nga fondi rezervë ose nga shumat suplementare.

Neni 24

Shoqëria gëzon të gjitha të drejtat dhe mbrojtjen e pasurive të saj nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

V. PUNËSIMET NË SHOQËRI

Neni 25

Për punonjësit që do të punësohen, marrëdhëniet juridike midis shoqërisë dhe të punësuarve do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punës në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 26

Shoqëria merr përsipër të derdhe rregullisht të gjitha detyrimet, gjithashtu dhe kontributet për sigurimin e të punësuarve të saj në organet kompetente përkatëse, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

VI. PRISHJA E SHOQËRISË, LIKUIDIMI

Neni 27

Shoqëria priset para kohe kur:

- Aktiviteti ekonomik i saj për disa vjet rradhazi është me humbje.
- Për arsye të parashikuara me ligj.
- Në çdo rast tjetër me vendim të të tërë ortakëve.

Neni 28

Shoqëria hyn në procesin e likuidimit që në momentin e marrjes së vendimit për prishjen e saj. Për kryerjen e këtij procesi, të tërë ortakët emërojnë një ose dy likuidatorë, të cilët i paraqesin raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të shoqërisë.

VII. KUSHTET E TJERA

Neni 29

Të gjitha vendimet e tërë ortakëve regjistrohen në libër të vecantë që mbahet në selinë e shoqërisë.

Neni 30

Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin lidhur me objektin e veprimtarisë së shoqërisë dhe që nuk zgjidhen me mirëkuptim, organi kompetent për zgjidhjen e tyre është ERE-ja. Apeli kundër Vendimeve të ERE-se është *Gjykata e Shkalles së Parë të Rrethit, Tiranë*.

Neni 31


Ky statut është hartuar në qytetin e Tiranës, sot më 10.10.2005

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË "FAVINA 1" SH.P.K.

Adnand Qylafi



Viktor Qylafi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NOTERIA E TIRANËS

Nr. 3102 rep.

Nr. 259 kol.

VËRTETIM

Sot në datë 14/10/2005 para meje, Noteres, u paraqitën personalisht Z. Viktor Qylafi, i datëlindjes 1963, me pasaportë Nr. Z 0166919 dhe Adnand Qylafi, i dt. 1966 me pasaportë Nr. Z 1060644 persona madhorë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, të cilët më deklaruan se statuti dhe kontrata e themelimit është hartuar prej tyre me vullnet të lirë. Unë, Noterja, e vërtetoj rregullisht dhe e firmos duke i dhënë forcën ligjore.

PULLE TAKSË



100
LEKE

R. SHQIPËRISE

NOTERE

